



# USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 15 (827819)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 14 prill 2023

## SHSHP, gjeneral brigade Arben Kingji pret Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim zyrtar Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, vizitë kjo, e para për gjeneral Ristuccia në Shqipëri. Në takimin e zhvilluar mes dy delegacioneve, gjeneral Kingji vlerësoi maksimalisht angazhimin e KFOR-it në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë në Kosovë

dhe rajon. "Duke marrë në konsideratë dhe situatat delikate me të cilat përballen KFOR-i dhe institucionet atje, e konsiderojmë të rëndësishme kontributin tuaj për të ndërtuar "ura" bashkëpunimi me në thelb besimin e ndërsjellë mes komuniteteve në Kosovë. Shqipëria do të mbajë gjithmonë qëndrime konstruktive në të gjitha nismat me në thelb mbrojtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë

së Kosovës. Mbështesim dialogun Kosovë – Serbi, si një ndër hapat më të rëndësishëm që do i hapë rrugë zgjidhjeve të mëtejshme të problematikave në funksion të integritimit në strukturat ndërkombëtare". Gjeneral Ristuccia nga ana e tij u shpreh se "Shqipëria për ne është një aleat i vyer, për vetë kontributin dhe mbështetjen politike - ushtarake që jep në..."

»» faqe 2



## Ministri Peleshi pret Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia



»» faqe 3

Kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një vizitë zyrtare në komandën e Forcës Detare në Varna, Bullgari

Komandanti i Forcës Detare, Kundëradmiral Adnand Agastra, me ftesë të homologut të tij, zhvilloi një vizitë zyrtare në komandën e Forcës Detare në Varna, Bullgari. Pas pritjes me ceremoni zyrtare, komandanti i Forcës Detare të Bullgarisë, kundëradmiral Kyril Mihaylov u shpreh se kjo vizitë ka rëndësi historike, pasi është hera e parë që një komandant i Forcës Detare shqiptare zhvillon një vizitë zyrtare në Bullgari. Qëllimi i vizitës ishte forcimi i bashkëpunimit dypalësh, shkëmbimi...



»» Faqe 3

Ambasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri mban leksion si "Guest speaker" në KLSM-13

Ambasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri, z. Tayyar Kagan Atay, mbajti leksion si "Guest speaker" për Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-13). Ai u prit nga drejtues të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, të cilët i uruan mirëseardhjen si përfaqësues i nivelit të lartë dhe e falënderuan për pranimin e ftesës si i ftuar nderi pranë grupit të KLSM-13. Ambasadori i shtetit Turk, zoti Atay nga ana e tij falënderoi për pritjen dhe më tej prezantoi për...



»» Faqe 4

Të vdesësh për Atdhe, kjo është punë mbretërishe!

Vendlindja është dashuri, është malli dhe krenaria e origjinës, është rrëfjë e vjetër sa bota. Sa herë diskutoj me miqtë e mi, ata shpesh më drejtojnë pyetjet: Kush ishin banorët e hershëm të këtyre trojeve? Nga e ka origjinën emri i vendlindjes tonë? A ruhet vazhdimësia etnike iliro-arbërore në trojet tona? Cilat janë vlerat patriotike, shoqërore, kulturore, arsimore dhe fetare të banorëve të kësaj treve? Këto kërkesa të drejta më nxitën të hulumtoj për vendlindjen, të rikthehem pas në vite, duke shtegtuar pa anë e fund në historitë...



»» Faqe 5

# SHSHP, gjeneral brigade Arben Kingji pret në një takim zyrtar Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim zyrtar Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, vizitë kjo, e para për gjeneral Ristuccia në Shqipëri.

Në takimin e zhvilluar mes dy delegacioneve, gjeneral Kingji vlerësoi maksimalisht angazhimin e KFOR-it në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon. “Duke marrë në konsideratë dhe situatat delikate me të cilat përballen KFOR-i dhe institucionet atje, e konsiderojmë të rëndësishme kontributin tuaj për të ndërtuar “ura” bashkëpunimi me në thelb besimin e ndërsjellë mes komuniteteve në Kosovë. Shqipëria do të mbajë gjithmonë qëndrime konstruktive në të gjitha nismat me në thelb mbrojtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së Kosovës. Mbështesim dialogun Kosovë – Serbi, si një ndër hapat më të rëndësishëm që do i hapë rrugë zgjidhjeve të mëtejshme të problematikave në funksion të integritetit në strukturat ndërkombëtare”.

Gjeneral Ristuccia nga ana e tij u shpreh se “Shqipëria për ne është një aleat i vyer, për vetë kontributin dhe mbështetjen politike - ushtarake që jep në misionin KFOR, si dhe është pro gjetjes së alternativave për zgjidhjen e konflikteve mes Kosovës dhe Serbisë. Si mbështetëse e fortë e dialogut mes dy vendeve (Kosovë-Serbi), kjo është mjaft e rëndësishme për KFOR-in, pasi Shqipëria ka një influencë në aspektin politik dhe vullnet të mirë për të gjetur



gjithmonë zgjidhje.

Në përfundim të takimit zyrtar, të dy autoritetet reciprokisht falënderuan përkushtimin dhe bashkëpunimin e frytshëm në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon. Gjatë vizitës zyrtare njëditore, Komandanti i KFOR-it, gjeneral major Ristuccia do të zhvillojë takime të tjera të rëndësishme zyrtare me Presidentin e RSH-së, Sh. T. z. Bajram Begaj dhe Ministrin e Mbrojtjes z. Niko Peleshi.



**GJENERAL KINGJI VLERËSOI MAKSIMALISHT ANGAZHIMIN E KFOR-IT NË RUAJTJEN E QËNDRUESHMËRISË DHE SIGURISË NË KOSOVË DHE RAJON. “DUKE MARRË NË KONSIDERATË DHE SITUATAT DELIKATE ME TË CILAT PËRBALLEN KFOR-I DHE INSTITUCIONET ATJE, E KONSIDEROJMË TË RËNDËSISHME KONTRIBUTIN TUAJ PËR TË NDËRTUAR “URA” BASHKËPUNIMI ME NË THELB BESIMIN E NDËRSJELLË MES KOMUNITETEVE NË KOSOVË.**



STAFI

**ANJEZA MUSOLLARI**  
Shefe e Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:  
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:  
Suela **HODA**

Graphic Designer:  
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”



## Ministri Peleshi pret Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia

**M**inistri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi priti në një takim zyrtar Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia.

Në fjalën e tij z. Peleshi do të shprehej se: “Misioni i KFOR-it në Kosovë ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajonin tonë. Shqipëria mbështet rifillimin e dialogut Kosovë-Serbi dhe çdo përpjekje ndërkombëtare për marrëveshjen finale në normalizimin e raporteve, që duhet të mundësojë njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE”.

Më tej ata diskutuan për bashkëpunimin dhe angazhimet e vendit tonë në kuadër të NATO-s apo nismave rajonale, si aleatë të besueshëm dhe kontribuues aktivë.



## Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një vizitë zyrtare në komandën e Forcës Detare në Varna, Bullgari

**K**omandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, me ftesë të homologut të tij, zhvilloi një vizitë zyrtare në komandën e Forcës Detare në Varna, Bullgari. Pas pritjes me ceremoni zyrtare, komandanti i Forcës Detare të Bullgarisë, kundëradmiral Kyril Mihaylov u shpreh se kjo vizitë ka rëndësi historike, pasi është hera e parë që një komandant i Forcës Detare shqiptare zhvillon një vizitë zyrtare në Bullgari.

Qëllimi i vizitës ishte forcimi i bashkëpunimit dypalësh, shkëmbimi i eksperiencave në modernizim dhe eksplorimi i mundësive për bashkëpunim në fushën e edukimit dhe trajnimeve. Kundëradmiral Agastra u shpreh se dy vendet tona ndajnë të njëjtat vlera, jo vetëm se janë në të njëjtën aleancë, por edhe se ndodhemi në të njëjtën rajon. Kundëradmirali u njoh me zhvillimet më të fundit, planet



e modernizimit me dy korveta të reja si dhe u informua mbi situatën në Detin e Zi. Pjesë e takimit ishte dhe vizita në kantierin e ndërtimit të anijeve “MG Dolphin” dhe njohën nga afër ndërtimin e korvetave të reja për

Forcën Detare bullgare. Takimet përfunduan me një vizitë në Akademinë e Marinës së Bullgarisë në të cilën u prit nga komandanti/rektori i kësaj akademie, kundëradmiral prof. dr. Boyan Mednikarov.





# Ambasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri mban leksion si "Guest speaker" në KLSM-13

**A**mbasadori i Republikës së Turqisë në Shqipëri, z. Tayyar Kağan Atay, mbajti leksion si "Guest speaker" për Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-13). Ai u prit nga drejtues të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, të cilët i uruan mirëseardhjen si përfaqësues i nivelit të lartë dhe e falënderuan për pranimin e ftesës si i ftuar nderi pranë grupit të KLSM-13. Ambasadori i shtetit Turk, zoti Atay nga ana e tij falënderoi për pritjen dhe më tej prezantoi për pjesëmarrësit temën "Qasja e Turqisë në Ballkan: Vlerësim i zhvillimeve të fundit në rajon", duke u ndalur në situatën e sigurisë në Ballkan, rolin dhe ndikimin e shtetit Turk në mjedisin e ri të sigurisë të ndryshuar dhe nga lufta në Ukrainë.

Më pas Ambasadori, z. Atay, bashkëbisedoi me pjesëmarrësit e kursit për situatën aktuale të sigurisë dhe mbrojtjes në rajon dhe më gjerë si dhe marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Turqisë si vende që bashkëpunojnë në fusha të ndryshme. Pjesëmarrësit e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes treguan interes dhe adresuan pyetje mbi temën e prezantuar.



**K**ursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen zhvilloi një vizitë treditore në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Kosovës, ku vizitoi Komisionin Parlamentar për çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Ministrinë e Mbrojtjes, bazën e KFOR-it (Kosovo Force) si dhe zyrën e UNMIK-ut (United Nations Mission in Kosovo).

Gjatë ditës së parë stafi akademik dhe pjesëmarrësit e KLSM-13 u pritën në Komisionin Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes nga z. Bekë Berisha kryetar dhe anëtarë të tjerë, Deputetë në Parlamentin e Kosovës. Në këtë takim u diskutua mbi prioritetet e sigurisë kombëtare, rruga drejt anëtarësimit në NATO dhe hapat për integrimin në Bashkimin European të Kosovës.

Më pas pjesëmarrësit e KLSM-13 vizituan Ministrinë e Mbrojtjes, ku u pritën nga Ministri i Mbrojtjes z. Armend Mehaj i shoqëruar nga gjeneralmajor Gëzim Hazrolli dhe gjeneralmajor Irfete Spahiu. Z. Mehaj mbajti një ligjëratë, ku trajtoi tema nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë dhe rajon. Ai u ndal në reformën institucionale që po ndjek Republika e Kosovës në fushën e mbrojtjes, transformimet në proceset e shtet-ndërtimit me qëllim kryesor anëtarësimin në NATO dhe integrimin në BE. Ai u shpreh se këto dy aleanca të ndryshme kanë të njëjtin qëllim për qytetërimin perëndimor,

## KLMS-13 zhvillon vizitë mësimore në institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë në Republikën e Kosovës



mbrojtjen e vlerave demokratike, ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në mbarë botën. Ligjëratat e z. Mehaj u ndoq me interes dhe në fund të saj nga pjesëma-

rrësit e KLSM-13 u adresuan pyetje të ndryshme për temat e diskutuara.

Programi akademik vijoi me vizitën në bazën e KFOR-it, ku stafi dhe

pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen u pritën nga shefi i shtabit i KFOR-it, i cili i uroi mirëseardhjen, duke i përgëzuar pjesë-

marrësit për ndjekjen e këtij kursi të nivelit strategjik. Më pas ai i njohu me situatën e sigurisë në veri të Kosovës, grupet opozitare si dhe sfidat aktuale. Më pas, me anë të prezantimeve nga përfaqësues të degës së zbulimit, operacioneve dhe planifikimit, pjesëmarrësit u njohën mbi misionin e KFOR-it, detyrat, bashkëpunimet, planifikimin si dhe situatën e sigurisë në Kosovë. Gjatë sesionit të pasdites, KLSM-13 vizitoi zyrën e UNMIK-ut, ku u prit nga shefi i Zyrës së Koordinimit Ushtarak, i cili i njohu me detyrat e zyrës së koordinimit dhe organizimin e saj. Vizita e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen në Republikën e Kosovës arriti qëllimin akademik të programit, duke bërë të mundur për pjesëmarrësit e KLSM-13 njohjen me strukturën, detyrat dhe sfidat e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes që operojnë në Kosovë.

**Drilona Hoxhaj**



**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit të Botimeve

# Të vdesësh për Atdhe, kjo është punë mbretërisht!

**V**endlindja është dashuri, është malli dhe krenaria e origjinës, është rrëfenjë e vjetër sa bota.

Sa herë diskutoj me miqtë e mi, ata shpesh më drejtojnë pyetjet: Kush ishin banorët e hershëm të këtyre trojeve?

Nga e ka origjinën emri i vendlindjes tonë? A ruhet vazhdimësia etnike iliro-arbërore në trojet tona?

Cilat janë vlerat patriotike, shoqërore, kulturore, arsimore dhe fetare të banorëve të kësaj treve?

Këto kërkesa të drejta më nxitën të hulumtoj për vendlindjen, të rikthehem pas në vite, duke shtegtuar pa anë e fund në historitë e kësaj treve të lavdishme, kërkova nga lashtësia e largët dhe mesjeta e duke udhëtuar ndër vite, arrita në ditët e sotme dhe ajo që zbulova ishte se e gjithë bota shqiptare është histori e lashtë sa bota, dhe se në çdo cep të saj mund të gjesh pjesët e 'pazëllit' së të gjithës tënde.

Gjëja më e shtrenjtë! Vendi ku u lindëm e u rritëm, ku morëm mësimet e fëmijërisë, ku jetuam gëzimet dhe hidhërimet tona. Aty u formuam, hodhëm hapat e parë dhe nisëm rrugën e jetës...

Vendlindja është kjo tokë, këta gurë e drurë që në çdo moment na kujtojnë origjinën tonë. Lavdia e të parëve është dritë për pasardhësit! Është thirrja e kohës për të njohur Vendlindjen dhe kushtrimi i të parëve për të dashur Atdheun.

Në një moment, kur isha në mesin e të tridhjetave dëgjova zërin e gjyshes. Dhe papritmas e gjithë jeta mu duk e dështuar. Zëri i saj kumbonte: "Nëse bën edhe një hap më tej, nuk do të kthehesh më prapa, do të bëhesh e huaj përgjithmonë, nuk do të kesh më një vend që të jetë kaq i rëndësishëm për ty, që të të duan të qëndrosh atje. Sepse çdo qenie njerëzore ka vetëm një gjuhë dhe një shtëpi, ndoshta dhe vetëm një qytet dhe një peizazh".

Kush ka të drejtë – unë apo gjyshja? A jemi ne njerëzit të dënuar që si të rinj të ëndërrojnë të jetojmë një jetë të re, ndryshe nga kufijtë e ngushtë të vendlindjes sonë dhe pastaj dekada më vonë për t'u dhënë të drejtë të moshuarve dhe për t'u kthyer të penduar në shtëpinë e prindërve?

## **E keqja jashtë**

Prindërit nuk më kanë predikuar në fëmijërinë time që bota e largët është një xhungël mizore. Megjithatë në dekadën e fundit të Perdes së Hekurt kishte shumë arsye për këtë. Në shtëpi më kanë dhënë një mësim tjetër: e keqja e botës nuk ndalet në qytetin dhe



farefisninë tonë. Aktualisht këtë e tregon edhe fushata në mediat sociale.

Një numër i madh njerëzish, shumica gra, raportojnë për përvojat e tyre pjesërisht traumatike. Disa i kanë bërë ato jashtë vendit ose me të huaj, por shumë edhe në ambientin e tyre të afërt: si fëmijë në shtëpi dhe midis të afërmeve, në jetën e tyre profesionale dhe në mjedisin më të afërt shoqëror. Çdokush që ka qenë i prirur të mendojë, se vetëm të huajt ngacmojnë dhe përdhunojnë, ka nevojë urgjente për një përditësim.

Çfarë më thotë kjo? Bota e përsosur,

amtare është një ëndërr?

Ajo është një utopi?!

Në një nivel personal, ekzistencial, ajo gjithmonë e ka shoqëruar njerëzimin. Për disa, kjo ëndërr mund të ketë sjellë fat, për të tjerët, krijon presion. Në një mjedis familjar, kjo ëndërr shpesh shndërrohet në të vërtetë, por shumë shpesh kjo nuk është asgjë më shumë se një gënjeshtëri. Në fund të fundit, është një rastësi se ku ndeshesh me të keqen e botës: në qytetin tënd ose në një të huaj. Transferuar në nivelin politik, gënjeshtria e botës së shenjtë brenda vendit, shpesh

shndërrohet në një instrument pushteti. Së bashku me konceptin e kombit dhe të identitetit, kjo gënjeshtëri është një nga shpikjet mashtruese të shekullit të 21-të. Pa to, nuk do të ishte e mundur të mobilizoheshin dhe fanatizoheshin miliona njerëz që në shekullin e njëzetë e një ishin gati të sakrifikonin lumturinë e tyre personale, të linin familjet e tyre dhe të shkonin në luftë për të vrarë njëri-tjetrin. Atdheu në nivelin e politikës është lëndë shpërthyes.

## **Njerëzit si Atdhe**

Vendlindja ime, Korça është vetëm

një prej qyteteve të 28 748 km<sup>2</sup>, të sipërfaqes që atdheu ynë Shqipëria na ofron me dashuri pa kushte.

## **Vendlindja nuk do dashuri të cunguar**

Vendlindja, vendi ku robërohet shpirti. Nuk ka sëmundje më fisnike se sa malli për vendlindjen, e vendi i huaj nuk të bëhet atdhe.

Në atdhe njeriu ka të kaluar, por edhe të ardhme. Në vend të huaj ke vetëm të tashme.

Patriotizmi i vërtetë nuk është ai që kërkohet dhe mburret në çastet solemne, por ai që çdo ditë e çdo orë kujdeset pa u lodhur për të mirën e përgjithshme dhe nuk mburret me këtë.

Atdheun e duam, jo se është më i madh apo më i vogël, por sepse është i joni, është gjaku dhe rrënja. Vendlindja është vetëm një, ashtu sikurse nëna. Kujt i takon virtyti i mirë, atij i takon dhe vendlindja. Atdheu - vendlindja janë një, janë gjeneza e qenies sonë.

Kush vdes për atdhe, nuk ka vdekur, por ka rilindur.

Një dimër në atdhe është me i ëmbël se qindra pranvera në dhe të huaj.

Dhe nëse dëshiron ta njohësh atdheun dhe të provosh se sa shumë e do atë, shko në dhe të huaj dhe do të provosh atë ndjesinë që ke kur je larg familjes tënde.

Të vdesësh për Atdhe, kjo është punë mbretërisht!



# Strategjia e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të interesave Kombëtare



GJENERAL BRIGADE (R)  
PIRO AHMETAJ

**P**a asnjë mëdyshje, agresioni ushtarak i Rusisë - Putiniste kundër tërësisë territoriale të një vendi sovran (Ukrainës), mbetet gjithashtu një kërcënim, sfidë dhe kabanë e fortë alarmi për sistemin dhe instrumentet globale të sigurisë.

Përveç luftës në Ukrainë, mësimet e nxjerra nga operacionet dhe angazhimet e gjata të NATO-s në Irak, Afganistani, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë etj., si dhe pesha e kërcënimeve kibernetike etj., po/do të shërbejnë si domosdoshmëri kritike për të transformuar dhe modernizuar jo vetëm institucionet e sigurisë globale (UN/NATO) por edhe ato kombëtare të çdo vendi.

Nga ana tjetër duhet ta ripërsërisim se për 30 vendet e NATO-s, tërësia territoriale mbetet përgjegjësi kolektive. Kjo është thelbësore, por kurrsesi një dhuratë e përjetshme pasi secili nga 30 vendet kanë obligimin të zhvillojnë kapacitete që i përkasin për përmbushjen e misionit të përbaljes së Aleancës me rreziqet konvencionale, ose sulmet ushtarake.

Prandaj çdo vend i NATO-s, por jo vetëm ato, po zhvillojnë Strategji (që harmonizon objektivat, mënyrat dhe mjetet/buxhetet) si dhe po modernizon aftësitë operacionale të fokusuara në mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave Kombëtare.

Si parim, rishikimi periodik i Strategjisë "imponohet" nga dinamika e ambientit të sigurisë, nga pesha e rreziqeve si dhe respektivisht impaktit të tyre ndaj interesave kombëtare. Po ashtu, përtej emërimit, rishikimi ciklik i Strategjive Nacionale mbetet si domosdoshmëri kritike jo vetëm për të modernizuar instrumentet dhe kapacitetet e sigurisë kombëtare, por edhe për të reflektuar ndryshimet e konceptit strategjik të NATO-s, si dhe përmbushur detyrimet në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së etj.

Përtej modestisë së tepruar, në kapacitetin e ekspertit me eksperiencë në reformat e Sigurisë Kombëtare, Rajonale dhe të NATO-s si dhe në përgatitjen e dokumenteve strategjike (SSK, SU, RSM-2013, PAZH, etj.) po paraqes një vlerësim me gjetje, parime si dhe 10 rekomandime strategjike për domosdoshmërinë e hartimit të Strategjisë së Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Interesave Kombëtare (SM, ZhIK) të Republikës së Shqipërisë:

Vullnet, përpjekje dhe masa



gjithëpërfshirëse, jo vetëm në rrafshin e vendimmarrjes Politike, por në të gjitha hallkat, Institucionet, Agjencitë Shtetërore si dhe fazat e përgatitjes së draftit të Strategjisë. Për më qartë, grupi i punës nuk do duhet kurrsesi të përbëhet nga vetëm "burokratë të emëruar", por nga personalitete të mirënjohur, shtetarë të përgjegjshëm, patriotë mendje hapur si dhe me eksperiencë të spikatur në fushën e mendimit strategjik dhe reformave të sigurisë kombëtare.

Gjithëpërfshirje dhe konsensus sa me i gjerë. Shpresoj që 32 vjet të kemi mësuar se një Strategji pa konsensus apo e prodhuar në frymë konfliktuale, mbetet një dokument i padobishëm, pra një dokument inventar, që dublikon "pa kurrfarë lidhje" programin e qeverisë së radhës.

Është po ashtu fakt se në më shumë se 3 dekada të përpjekjeve të RSH-së për ndërtimin e Shtetit demokratik, të bazuar në parimin "check and balance", një nga vlerat e gjithë-pranuara që do duhet të "gjunjëzohej/t" klasa politike mbeten çështjet e Interesave Kombëtare. Në shtesë, kjo qasje do të demonstronte edhe pjekuri dhe përgjegjshmëri të klasës politike dhe po ashtu do shërbejë si një mesazh i fortë pozitiv për partnerët strategjik, SHBA, NATO, BE etj.

Vizion strategjik, për të peshuar dhe balancuar skenarët e kërcënimeve të mundshme me interesat kombëtare. Prandaj në përgatitjen e SM&ZhIK, duhen angazhuar personalitete me ekspertizë dhe integritet të spikatur në fushën e politikës, ekonomisë, diplomacisë, inteligjencës, informacionit/IT, gjeneralë; Emergjencat Civile, Policia e Shtetit, Akademia e Shkencave, etj.

Konsultim me aktorët e shoqërisë civile, qendrat e studimeve strategjike,

akademikë të mirënjohur dhe grupet e interesit, është jo vetëm një "kërkesë në modë", por para së gjithash një detyrim dhe prove e përgjegjshmërisë shtetërore, me qëllim për t'i dhënë dokumentit të Strategjisë dimension dhe garanci aplikative. Nuk është shpikje, p.sh në NATO dhe vendet perëndimore, për zhvillimin e dokumenteve strategjike angazhojnë personalitete ose "grup të urtësh" si dhe ekspertë me peshë strategjike dhe jo vetëm grupe pune nga "burokracia/zyrtarë të emëruar".

## Kohezioni mbarëkombëtar

Organizimi i konferencave shkencore apo dëgjesave publike për strategjinë, duke hapur edhe një website të posaçëm, ku çdo qytetar i interesuar shpreh mendimet e veta.

Me tej, produkti do duhet të konsultohet me Kolegjin e NATO-s, "Qendrën Marshall", NDU/USA, etj. për të marrë edhe "certifikatën" e institucioneve elitare në fushën e mendimit gjeostrategjik.

E parë nga sa sipërpërmendur, çdo produkt (Strategji) burokratike, pra që do i mungonte gjithëpërfshirja, konsensusi dhe konsultimi do "mbetej në klasë si dokument inventar", dhe kështu do t'i shkonte shprehja Amerikane "breathing new life into dead reckoning", ose e përkthyer, "i/e vdekur pa lindur ende".

Mirë peshimi i rreziqeve dhe mjedisit të sigurisë. Ukraina na tregoi qartë, se jetojmë në një realitet, ku nuk janë zhdukur përgjithmonë rreziqet konvencionale, ose sulmet ushtarake ndaj integritetit territorial.

Ndërsa po ashtu Krimea, Kosova, Bosnja, etj., na kanë treguar, se kërcënimet po sofistikohej nëpërmjet

përdorimit të formave të reja si referendumet e mbështetura nga jashtë, fundamentalizmit fetar, destabilitetit financiar, krimin të organizuar, axhendës së politikanëve të korruptuar, qeverisjet e dështuara, etj.

Anëtarësimi në BE, të ri Konfirmohet, jo vetëm si mision dhe opsion i vetëm, por edhe si një projekt që i bashkon mbarë shqiptarët, rreth vlerave perëndimore, të drejtën e jetës, fjalës, pronës dhe tregut të lirë. Ose e thënë më mirë nga një mendje atërore, si Profesor Sami Repishti: "integrimi në bashkësinë e vlerave Euroatlantike (BE me 450 milion banorë) mbetet shprehje e aspiratës dhe Fat i bardhë i së ardhmes së Shqipërisë dhe Kosovës!"

Modernizimi i kapaciteteve operacionale për përbaljen me emergjencat/fatkeqësitë natyrore, industriale dhe njerëzore. Ndërsa mbetet ende të përmirësohen mekanizmat e kontrollit civil, demokratik të strukturave/agjencive përgjegjëse, për të mos lënë hapësira të devijimit nga misioni Kushtetues, si dhe për më tepër, për të shmangur shpërdorimit nga klientët e pushtetit të burimeve të mbrojtjes kombëtare. Objektivat strategjike do duhet të shoqërohen me një Plan/Matricë veprimi me aktivitete, përgjegjësi shtetërore të matshme si dhe mbështetje me financa adekuate.

Thënë këtë, do duhet paraprakisht të ngrihej Agjencia e Sigurisë Kombëtare (ASK), e cila do të shërbejë për t'u siguruar në kohë reale, autoriteteve të larta shtetërore, pikurën dhe peshën e kërcënimeve ndaj interesave Kombëtare, si dhe do të luajë një rol thelbësor në formulimin e dokumenteve bazë të Sigurisë Kombëtare, përgatitjen

e paketës ligjore, monitorimin e realizimit të objektivave sipas matricës së detyrimeve ndërinstucionale, etj.

Përmbushjen e detyrimeve dhe përmirësimin i kredibilitetit të RSH-së në NATO dhe partnerët Strategjik (USA). Ndërkohë, 14 vjet pas anëtarësimit, shqiptarët e kanë tejkaluar perceptimin e NATO-s si "bankë alienësh" që garanton falas paprekshmërinë territoriale të 30 vendeve anëtare. Thënë këtë, RSH-së i duhet të arrijë Buxhetin e Mbrojtjes në 2% të GDP-së, që për vitin tjetër, 2024.

Në shtesë, do t'i ri Këshilloja publikisht aktorët politik dhe faktorët institucional të Tiranës dhe Prishtinës që për interesat jetike kombëtare: "të përulën në gjunjë para përgjegjësive shtetërore, duke projektuar dhe zyrtarizuar një qasje të drejtë dhe të mençur (dy shtete sovraane një komb i vetëm), që përfshin sovranitetin por fokusohet në mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave mbarëkombëtare. E ritheksoj se kjo "qasje e fortë por e vonuar" nuk kërcënon asnjë vend, përkundrazi do të kontribuojë si balancë dhe garanci shtesë për paqen afatgjatë dhe axhendën Euroatlantike të rajonit. Për të tejkaluar edhe një "kujdes diplomatik", sjellim shembullin e vendeve skandinave (Norvegji, Suedi, Finlandë); Baltike (Lituan, Letoni, Estoni); të Vishegradit, qasjen zyrtare të Turqisë dhe Greqisë në raport me Qipron, rastin USA me Islandën, etj.

Me këtë rast, ri-konfirmoj se mbetem sa i përkushtuar, aq edhe i përulur, për të kontribuar me eksperiencë dhe ekspertizë strategjike në përgatitjen e Strategjisë së Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Interesave Kombëtare në Rajon, Mesdhe dhe më gjerë!

# Krijimtaria e piktorit ushtarak shqiptar me vizion european

**R**obert Përmeti u lind në Tiranë, më 25.05 1949 dhe banon në Tiranë.

Rrjedh nga një familje intelektuale, babai ish-kolonel i Ministrisë Brendshme (jurist) dhe nëna nëpunëse. Për shkak të profesionit të babait, Roberti ka banuar në shume qytete si në Vlorë, Shkodër, Tiranë etj... Shkollën fillore e ka mbaruar në Vlorë, e më pas në Tiranë, respektivisht në shkollën "Qemal Gorishova" dhe Halim Xhelo në Vlorë e më pas në shkollën "Petro Nini Luarasi", shkollën "Barjam Curri"... Skënderbegasi Robert Përmeti, është piktori që me talentin e tij, ka bërë emër jo vetëm në Shqipëri, por dhe në shumë kontinente, duke kontribuar dukshëm për njohjen e pasqyrimin e vlerave të pikturës shqiptare tek specialistët e njohur ndërkombëtar dhe tek artdashësit e shumtë...

Në vitin 1963 konkurroi për pikturë, në Liceun Artistik të Tiranës dhe fitoi. Por me këmbënguljen e ish-komandantit të shkollës "Skënderbej", Luto Haxhiut, u regjistrua në këtë shkollë me premtimin që të vazhdonte njëherësh edhe Liceun Artistik. Ky premtim nuk u mbajt nga komandanti i shkollës, kështu përfundoi skënderbegasi dhe ndërkohë filloi edhe shkollën e Kulturës. Vazhdimi i dy shkollave paralel ishte pak i vështirë, duke pasur parasysht moshën trembëdhjetë vjeçare. Në vitin 1964 filloi stërvitjen për paradën e radhës, bashkë me shumë të tjerë, por në fund do të mërziej sepse nuk mori pjesë në parakalimin final mbasi nuk plotësoja kriteret e gjatësisë për kuadratet e skënderbegasve. Po këtë vit ishte i aktivizuar me shokët e shkollës "Skënderbej", për të realizuar stërvitjen e parë të atij lloji, "Kalimi i liqenit artificial të Tiranës me not dhe të veshur me uniformë, pajime ushtarake si edhe armatimin personal", që ishte një tip automatiku skorpions kinez. Kjo stërvitje qe e para e atij lloji dhe spektakli në kodrat e liqenit u ndoq nga gjithë tiranësit.

*Këto kujtime piktori do na i sillte kështu:*

"Sapo kishte mbaruar punimet kongresi i IV i PPSH-së, dhe bëmë një demonstrim për delegatët e huaj. Mbj mend që në momentin kur u rreshtuam të rruga kryesore pranë buzës së ujit, rrugë që ekziston akoma, ne ishim të lagur e gjithë llucë, ndërkohë frynte një erë brishtë dhjetori. Pas pak erdhën delegatët e kongresit të veshur me kostume e me ngjyra të ndryshme, të bardhë, të zinj, të verdhë të kuqërremtë etj. Para meje qëndroi një burrë elegant me kostum të zilizëm për atë kohë dhe më përqafoi. Kostumi gri iu bë për faqe te zezë nga lluca e liqenit, por ai nuk e çau fare kokën. Më pas, d.m.th. në vitin 1967, fillova Shkollën e Bashkuar për oficer. Bëra një vit praktikë në rolin e ushtarit në regjimentin e aviacionit luftarak Rinas e më pas mbarova Shkollën e Bashkuar për oficer në katedrën gjitharmëshe. Në kuadër të mbarimit të shkollës programi ynë u ndërpre pasi ndodhi pushtimi i Çekisë nga tanket ruse, e megjithatë në Tiranë



u organizua parada e radhës e vitit 1969. Kësaj radhe mora pjesë në kuadratin e oficerëve të rinj, pasi mbas shkollës "Skënderbej" unë isha ndër të paktët që kisha arritur zgjatje rekord, rreth 47 cm. Pra në këtë paradë ndryshe nga parada e vitit 1964, kisha arritur gjatësinë 180 cm.

Pasi u diplomova oficer, u emërova në Korpusin e Fierit. Për pak kohë në dispozicion të aparatit politik të këtij korpusi, emërohem komandant kompanie në Shkollën e Instruksionit, shkollë e porsahapur nga ky korpus. Ruaj kujtimet më të mira gjatë kohës që isha në këtë shkollë, sepse krijuam një shoqëri shumë të mirë pasi të gjithë instruktorët ishim pothuajse moshatarë. Këtu pata edhe vlerësime shumë të mira qoftë nga komanda e shkollës, qoftë edhe nga komanda e korpusit. Në këtë periudhë, nën drejtimin e komandantit të shkollës, oficerit të talentuar dhe shumë rigoroz Rahman Kumbaro, mu ngarkua organizimi i mësimit tregues në shkallë ushtrie, ku përfshiheshin armatime të reja të ardhura nga Kina, si granatahdhësit, mitralozat e rëndë të tipit "Gorjunov", por me tyta e sisteme të reja ftohëse. Për këto lloj armatimesh mungonin instruksionet dhe rregulloret përkatëse, kështu që krahas organizimit të qitjeve në kërkesa të ndryshme të terrenit, të kohës etj., duhej edhe të plotësonim edhe të dhënat taktiko-teknike të armëve. Për fat, gjithmonë kisha pranë Mustafa Takën, që ndërkohë ishte edhe qitës i ekipit të Apolonisë së Fierit. Bashkë me komandant Mustafën, bëmë qitje luftarake nga më të ndryshmet, sepse ai e kishte pasion këtë lloj sporti, por edhe unë nuk rrija pas, mbasi kam qenë qitës jo i keq, nuk mund të them shumë i mirë, sepse kishte të tjerë më të mirë se unë.... Këtë demonstrim e mësim tregues e realizuam me sukses. Ndërkohë, unë kalova instruktor zjarri, taktike e më pas instruktor zbulimi, gjë që do

t' më krijonte vështirësi më pas për të vazhduar Akademinë e Arteve. Mbas mbarimit të dy kurseve me studentë që diplomoheshin si oficerë rezervë, emërohem në ishullin e Sazanit si shef i Kulturës.

Në vitin akademik 1970, fitova konkursin për në akademinë e Arteve dhe kjo vetëm në saje të këmbënguljes të ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Petrit Dume dhe ish-drejtorit të Drejtorisë Politike, Hito Çako, e kuptohet me firmën e ministrit të Mbrojtjes Beqir Balluku.

Gjatë kohës që isha student në

një farë civili Adem Sollaku dhe përfundova në korpusin e Burrelit. Mbas një viti në këtë korpus emërohem shef Kulture në brigadën e Librazhdit. Kur filloi reforma në ushtri kalova në Divizionin e 22-të të Librazhdit përsëri me detyrën shef Kulture. Gjatë kësaj periudhë kam pasur një intensitet të vlerësueshëm si piktor dhe ndërkohë isha sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve për rrethin e Librazhdit e më pas Anëtar i Komitetit Drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, i zgjedhur nga kongresi i tretë i saj. Kam qenë i vetmi ushtarak i zgjedhur në këtë forum gjatë gjithë historisë së LSHA.

Më pas do t'i nënshtrohesh një punë intensive krijuese, krahas detyrës sime si ushtarak. Gjatë gjithë kësaj kohe tema ime e preferuar do të ishte tema e atdhedashurisë dhe personazhet e tablove të mia do të ishin gjithmonë shokët e kolegët e mi. Për herë të parë mora pjesë në ekspozitën e vitit 1975, organizuar me rastin e përvjetorit të FLD-së. Tabloja e parë ishte një temë lirike, "Marinarët në kohën e lirë" dhe një portret i palombarit të rëndë. Këto dy punime i realizova duke punuar në Pashaliman. Ndërsa më pas, d.m.th në vitet 1978-79, u paraqita në konkursin kombëtar, organizuar me rastin e 35 vjetorit të çlirimit, me tablonë "Denoncimi i Traktatit të Varshavës". Kjo tablo pati jehonë në qarqet artistike dhe në

vazhdoja të isha efektiv i Divizionit 22, në Librazhd. Mbas vitit 1990, kohë kur në Shqipëri sapo kishin nisur ndryshimet e sistemit, unë u thirra në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes për përgatitjen e sistemit të vendosjes së gradave të reja për ushtrinë e policinë. Për këtë projekt kisha punuar edhe më parë, kur ministër i Mbrojtjes ishte Kadri Hazbiu e më pas Prokop Murra.

Në vitin 1992, u emërova në Shtëpinë Botuese të Ushtrisë, ku pata rastin të bëhem pjesëtar i grupeve të punës për botimin e shumë titujve, që duhet të jenë mbi 300 të tillë. Më pas do të emërohesh pranë Shtabit të Përgjithshëm, në sektorin e Formimit të Brendshëm, deri në daljen në reformë.

Sot, në kushtet e pensionistit, vazhdoj krijimtarinë artistike, duke promovuar artin tim, jo vetëm brenda vendit, por në shumë shtete të ndryshme si Gjermani, SHBA, Angli, Itali, Francë, Bullgari, Finlandë, Greqi, etj. Veç pjesëmarrjes në konkurset vjetore të Akademisë Mbretërore të Anglisë, mund të përmend dokumentarin e realizuar nga regjisori amerikan Kaleb Wentzel Fisher dhe producentin gjerman Fabian Martin Diering, "Shqipëria e mbas viteve '60 e parë nëpërmjet pikturës sime". Promovimi i këtij dokumentari u realizua në Berlin, 2015.

I këtij interesi është edhe emisioni "Krijimtaria e një piktori



Akademinë e Arteve, në vitin 1974 fillova mbrojtjen e diplomës në FLD Vlorë dhe në vitin 1975, sepse diploma realizohej një vit në bazë. Pas diplomimit kalova në dispozicion të Komandës së FLD Tiranë.

Kur mbarova Akademinë e Arteve, me rezultate shumë të mira e me diplomë në fondin e artë të kësaj Akademie, u ndesha me keqdashjen e ish-drejtorit Politik të asaj kohe,

artdashësit e kohës. Më pas aktiviteti im do të pasurohej me shumë tablo pjesëmarrëse nëpër konkurset kombëtare si tabloja "Besa-Besë", "Flamurtarët", "Humnerë 44", "Aviatorët", "Duhet të fitojmë", "Brezat", etj. Disa nga tablotë e mia pjesëmarrëse në konkurset kombëtare janë zgjedhur si pjesë e fondit kombëtar.

Ndërkohë deri në vitin 1990,

ushtarak shqiptar", i gazetares e producentes së njohur suedeze, Lena Haglund, dhe regjisores Cecilia Ericson Grander, për televizionin suedez "Sveriges Television AB"...

Në të dy këto promovime, theksi dhe interesi ka qenë për tablotë "Dalja nga traktati i Varshavës", ku në qendër janë marinarët shqiptarë që mbajnë lart flamurin shqiptar.

# 6 shenja që tregojnë se tashmë e ardhmja ka ardhur

**N**donjëherë, kur shikojmë një film të mirë fantastiko-shkencor ose ngecim në trafik, ne ankojmë për faktin që nuk kemi teknologji futuriste tani. Por teknologjia e ardhshme mund të jetë më afër se sa mendoni. Është e mundur që disa nga gjërat që dëshironi, si më poshtë, janë shpikur tashmë dhe janë vetëm duke pritur për popullaritet të zakonshëm.

## Makina që vetëdrejtohen

Por numri i madh i të vrarëve e nxiti Ashokan të reflektonte thellë. Ai përqafoi menjëherë Budizmin dhe hoqi dorë nga dhuna dhe agresioni. Zbatoi një sërë politikash që synonin promovimin e harmonisë sociale dhe kulturore si dhe mësimet e Budës. Dekretet e tij përfshinin tolerancën ndaj feve të tjera, promovimin e mirëqenies sociale dhe vënien e theksit tek mos-përdorimi i dhunës dhe dhembshuria.

## Kleopatra VII, faraonia e fundit e Egjiptit

E famshme për bukurinë dhe zgjuarsinë e saj në politikë, ajo sundoi në vitet 51-30 Para Krishtit. Mbretërimi i saj u karakterizua nga politika e saj e jashtme ambicioze, e cila u fokusua tek një aleancë strategjike me Jul Cezarin e Romës.

Të dy u takuan në vitin 48, u dashuruan dhe sollën në jetë një djalë, Cezaronin. Kur u vra Cezari, Kleopatra lidhi në aleancë me Mark Antonin. Por ky u mund nga Oktavian Augusti, në vitin 30. Kleopatra dhe Antoni kryen vetëvrasje. Egjipti u pushtua nga Augusti dhe u shndërrua në një provincë të Romës.



**Bardhyli** (448 – 358 para Krishtit) ishte mbret ilir dhe themeluesi i dinastisë së parë të vërtetuar ilire. Gjatë mbretërimit të tij, Bardhyli bashkoi shumë fise ilire jugore nën mbretërinë e tij dhe mundi disa herë maqedonasit dhe molosët, duke mbretëruar mbi Maqedoninë e Epërme dhe Lynkestis.

Ai gjithashtu udhëhoqi sulmet kundër Epirit, por ushtarët e tij u dëbuan shpejt nga rajoni.

Ai arriti të bëhej mbret

pavarësisht nga rrënjët e tij të përlulura. Qymyrrxi dhe minator qymyrguri, mori pushtetin me dhunë pasi gëzonte simpatinë e luftëtarëve dardanë, sepse plaçkën e luftës e ndante në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Bardhyli nuk pasoi Sirrasin, por mbretin e mëparshëm ilir, i cili kishte lidhur një traktat paqeje me Amyntas II, mbi kontrollin e Lynkestëve. Bardhyli arriti të bashkonte fiset e ndryshme ilire dhe shpejt e bëri Dardaninë në një fuqi të frikshme në Ballkan, duke rezultuar në një ndryshim në marrëdhëniet me Maqedoninë. Nuk ka asgjë të regjistruar për të identifikuar qendrën e pushtetit dardan, me përjashtim të faktit se fitorja e Filipit në vitin 358 p.e.s. përfshiu që ai fitonte edhe kontrollin e Lynkestis. Prandaj, kryeqyteti i Bardhylit mund të ketë qenë i vendosur në këtë rajon. Megjithatë, selia e pushtetit mund të ketë qenë e vendosur në zemër të shtetit dardan, që korrespondon me atë që sot është Kosova.

**Bardhyli**, ndryshe nga mbretërit e mëparshëm ilirë, zhvilloi si aspektin ushtarak ashtu edhe atë ekonomik të shtetit të tij.



**Genti** (181 – 168 para Krishtit) i njohur edhe si Genci, ishte një mbret ilir që i përkiste dinastisë së lebeatëve që sundoi mes viteve 181 – 168 para Krishtit, Genti ishte djali i Pleuratit III, një mbret që kishte pasur marrëdhënie pozitive me Republikën e Romës. Kryeqyteti i Mbretërisë Ilire gjatë kohës së Gentit ishte Skodrinoni (Scodra).

## Kostandini I. 272

–337), i njohur gjithashtu si Kostandini i Madh, ishte një perandor romak që mbretëroi nga viti 306 deri në vitin 337 pas Krishtit dhe ishte i pari që konvertohet në krishterim. I lindur në Naissus, Dardani (tani Nish, Serbi), ai ishte djali i Flavius Constančius, një oficer i ushtrisë romake që kishte qenë një nga katër sundimtarët e Tetrarkisë. Nëna e tij, Helena, ishte greke. Kostandini shërbeu me dallim nën perandorët romakë Dioklecian dhe Galeri. Ai e filloi karrierën e tij duke bërë fushatë në provincat lindore (kundër barbarëve dhe persëve), përpara se të thirrej në perëndim (në vitin 305 pas Krishtit) për të luftuar përkrah të atit në Britani. Pas vdekjes së babait të tij në vitin 306, Kostandini u bë perandor. Ai u vlerësua nga ushtria e tij në Eboracum (Jork, Angli) dhe përfundimisht doli fitues në luftërat civile kundër perandorëve Maxentius dhe Licinius, për t'u bërë sundimtari i vetëm i Perandorisë Romake deri në vitin 324.



## Xhengiz Khan: Themeluesi i Perandorisë Mongole

Lindi në vitin 1162, dhe në fillim njihet me emrin Temuxhin. Më vonë u bë themeluesi i Perandorisë Mongole, perandorisë më të madhe që ka parë ndonjëherë bota. Këtë e arriti duke bashkuar disa fise mongole nën udhëheqjen e tij, dhe përmes pushtimeve që patën sukses falë strategjive të tij të shkëlqyera.

Nën drejtimin e tij, ushtria mongole u bë e famshme për shpejtësinë e rrafshme, disiplinën e rreptë dhe brutalitetin. Por veç kësaj, ai ishte i njohur edhe për tolerancën e tij fetare dhe mbështetjen ndaj tregtisë. Kur vdiq në vitin 1227, perandoria u nda midis djemve dhe nipërve të tij. Perandoria e tij pati një ndikim të madh, duke lehtësuar përhapjen e kulturës, fesë dhe teknologjisë në Azi dhe Evropë.

## Hatshepsut, faraonia e dytë grua

Hatshepsut ishte gruaja, vajza dhe motra e një mbreti. Por Egjipti kishte ligje dhe tradita të rrepta që e ndalonin sundimin e grave. Ndaj për t'u ngjitur në front Hatshepsut përdori dinakërinë e saj politike, prejardhjen mbretërore dhe ndikimin fetar. Pasi mori pushtetin nisi zbatimin e projekteve të mëdha ndërtimore që synonin legjitimimin e sundimit të saj.

Asnjë sundimtar para saj, nuk zbatoi aq shumë projekte ndërtimore sa ajo. Për të paguar për to, riktheu rrugët e vjetra tregtare dhe kreu disa pushtime në shtetet fqinje.

## Budica, mbretëresha luftëtare

Ishte mbretëresha e fisit kelt Icen, e famshme për udhëheqjen e popullit të saj kundër romakëve. Kur vdiq bashkëshorti, e dorëzoi mbretërinë e tij të vogël Romës me shpresën se ajo do t'i lejonte popullit të tij një formë pavarësie. Por romakët e shtypën brutalisht popullsinë kelte.

Kjo sjellje e frymëzoi Budicën të udhëheqë rebelimin e popullit të saj Icen dhe fqinjëve të tyre kundër Romës. Ushtritë e saj pushtuan Kolçesterin dhe shkatërruan Legjionin XIX. Ushtria e saj përparoi duke plaçkitur vendbanimet romake dhe duke i detyruar zyrtarët romakë të arratiseshin në Londinium (Londra e sotme).

Fatkeqësisht, sukcesi i saj ishte jetëshkurtër. Romakët u hakmorën në një betejë në periferi të Londrës. Budica refuzoi të tërhiqej. Ajo i udhëhoqi rebelët e saj në betejë dhe vdiq gjatë betejës ose diku më pas.

**Agroni** ishte mbret i Mbretërisë Ilire (Mbretërisë Ardiane) në shekullin III para Krishtit, rreth 250-231 para Krishtit. Djali i Pleuratit II, Agroni, arriti të shtrinte sundimin ilir mbi shumë fise, popuj dhe qytete në rajonin e Adriatikut. Ai është mbase më i njohur për fitoren e tij vendimtare ndaj Lidhjes Aetoliane, një shtet në Greqinë perëndimore.

Rreth vitit 231 para Krishtit, Agroni vdiq papritmas pas triumfit të tij mbi Aetolianët. Peneji, djali i tij me gruan e tij të parë Tritëuta, pasoi zyrtarisht babanë e tij si mbret, në vitin 231 para Krishtit, por mbretëria drejtohej nga gruaja e dytë e Agronit, Mbretëresha Teuta (Teuta e Ilirisë).



# V L O R A , parajsja e Jugut shqiptar

Vlora është një qytet bregdetar. Ajo nuk është vetëm një nga portet kryesore, por gjithashtu ka një rëndësi të madhe historike, sepse këtu u mbledh Asambleja në vitin 1912 për ta shpallur Shqipërinë një shtet të pavarur. Në Vlorë gjithashtu u formua Qeveria e Parë e kryesuar nga Ismail Qemali. Kështu, Vlora ishte kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur. Për të mësuar më shumë mbi këtë ngjarje mund të vizitoni Muzeun e Pavarësisë. Në një kodër mbi qytet mund të vizitoni vendin e shenjtë “Kuzum Baba”, nga ku mund të shijoni pamjen e detit dhe të gjithë qytetit.

## ÇFARË MUND TË VIZITOSH!

### Muzeu Etnografik i Vlorës, Pasqyra e Jetesës së Qytetit

Pjesë përbërëse e tre muzeve të qytetit të Vlorës, Muzeu Etnografik ndodhet shumë afër Muzeut Historik të Vlorës. Në këtë muze 37-vjeçar mund të gjeësh historinë e kulturës së pasur të qytetit bregdetar. Elementë të ndryshëm etnografikë të punuar nga banorët e zonës në etapa të ndryshme kohore. Çdo gjë që ka lidhje me veshjet tradicionale. Veglat e jetesës apo stilin e të jetuarit të familjeve vlonjate e shumë objekte të tjera që rrëfejnë për këtë qytet do i gjeni në këtë muze.



### Muzeu Historik

Qyteti i pavarësisë është njëri ndër vendet më të vizituar në të gjithë Shqipërinë. Buzë detit të këtij qyteti gjendet edhe shtëpia e selisë së Qeverisë së Vlorës, 1912.

Kjo godinë, fillimisht ka shërbyer si ndërtesë e Karantinës, e



pas shpalljes së pavarësisë, më 28 nëntor të vitit 1912, u bë selia e Qeverisë së Përkohshme të Ismail Qemalit për 14 muaj, deri më 22 janar të vitit 1914.

Nga viti 1936 deri në vitin 1939 ka shërbyer si muze historik.

Pasi kaluan 50 vjet nga vendimi i shpalljes së pavarësisë, godina u shpall Muze Kombëtar.

Godina përbëhet nga dy kate me nga dy dritare. Gjithashtu ka edhe dy hyrje, ku njëra nga hyrjet ka pamje nga deti ndërsa tjetra në drejtim të kundërt me të. Kur je para saj sytë të shkojnë direkt të ballkoni në të cilin u ngrit flamuri. Aty vazhdimisht qëndron një flamur krenar si përcjellës i gjurmëve të historisë sonë. Muzeu është i pajisur me dokumente të rëndësishme. Me fotografitë e Ismail Qemalit dhe të Isa Boletinit. Brenda godinës ju mund të shihni kabinetin e punës si dhe sallën e mbledhjeve të qeverisë së përkohshme të Ismail Qemalit, flamujt original të çetave kryengritëse, libra origjinalë të rilindësve të asaj periudhe. Pastaj disa objekte origjinale të Plakut mjekërbardhë si: kallamri me shqiponjën e bronzit, karrigia e punës etj.

Gjithashtu vlen të theksohet se ju do të keni mundësi të mira për të parë edhe objekte të tjera origjinale, që pasqyrojnë përpjekjet e luftërës e popullit shqiptar për çlirim kombëtar.

Një gjë është e sigurt, pasi të mbaroni vizitën në këtë vend kaq të rëndësishëm të historisë sonë, do të përjetoni ndjenja të papërshkrueshme kombëtare.

### Xhamia e Muradies

Nga qyteti mesjetar dhe mjaft i përmendur i Vlorës, sot ruhet në qendër të tij vetëm Xhamia e Muradies. Gjatë shekujve XV-XVI, Vlora ishte qendra e banuar më me rëndësi për perandorinë osmane në Shqipëri, falë pozitës që kishte porti i Vlorës në detin Adriatik. Atë, turqit e morën në vitin 1417. Gjatë shekujve XV-XVI, qyteti banohej vetëm nga të krishterët dhe çifutët. Me ndërtimin e kështjellës pranë portit nga sultan Sulejmani, në vitin 1583, përmenden vetëm 17 myslimanë, sepse pjesa tjetër e garnizonit qëndronte në kalanë e Kaninës. Për osmanët Vlora pati rëndësi në operacionet luftarake të vitit 1480 kundër Italisë. Më tej, ishte një bazë e sultan Bajazitit në luftën kundër kryengritësve himarjotë, ndërsa në vitin 1537 Sulltan Sulejmani qëndroi aty për të mbikëqyruar punimet e ndërtimit të kështjellës dhe ndërtoi dhe xhaminë.

Xhamia e Muradies përbëhet nga salla e lutjeve dhe minarja, ndërsa nga portiku i dikurshëm, në anën veriore, siç mendon dhe Kiel, ruhen bazamenti dhe gjurmët në mur të strukturave të drunjtave të çatisë.



### Kalaja e Kaninës

E cilësuar si një nga objektet më të njohura të trashëgimisë kulturore e historike në Vlorë e më gjerë, historia e ndërtimit të kalasë që nis prej shekullit IV p. e. s., përcjell periudhat e antikitetit dhe të Mesjetës (kronologjikisht bizantine, veneciane, turke), së bashku me teknikat respektive të ndërtimit. Kalaja është në një fushë të rrethuar me mure dhe përballë saj është deti, që duket si në pëllëmbë të dorës. Këto kanë qenë sarajet e pashallarëve të Kaninës.

Sulejmani i madhërisëm e ka vizituar Kaninën dhe ka lënë porosi ta kenë kujdes atë.

Kjo është pika ku, dashur pa dashur të gjithë vizitorët qëndrojnë dhe shikojnë fshatin, ata mahnitën nga bukuria. Në kala është edhe teqeja, më parë në vend të saj ka qenë një kishë dhe me ardhjen e Sulejman Pashait, admiralit i madh e ktheu në teqe.

Ernest Koliqi kur e pa për herë të parë Kaninën nga mali i Shashicës ka thënë: Për Kaninën. “Perëndia kur e pa si diell mbi det tha: ‘nuk është nga veprat e mia, këtë mrekulli dikush tjetër e ka bërë’”.

Struktura e ndërtimit të saj, evokon ngjashmëri me objekte të tjera si kalatë e Beratit, Durrësit etj. Kalaja ngrihet në majë të një kodre me lartësi 380 metra mbi nivelin e detit. Ajo ka një sipërfaqe prej 3,6 hektarësh. Prej këndeje hapet një pamje mjaft e bukur drejt Vlorës dhe gjirit të saj.

### Kalaja e Ali Pashës – Porto Palermo

Ajo është ndërtuar nga Ali Pasha si një dhuratë për gruan e tij, Vasiliqinë, të cilën, sipas kronistëve të kohës, Pashai i Janinës e kishte shumë për zemër. Bukuria dhe madhështia e kësaj kështjelle ka zënë vend në shumë libra kushtuar Ali Pashës. Për të, ashtu si dhe shumë të tjerë, ka shkruar edhe Aleksandër Dyma, autori i ‘Konti i Monte Kristos’. Kalaja ndodhet mbi një ishull rreth 30 m larg bregut, ku rripi i ngushtë ujqor midis bregut dhe ishullit është mbushur me dhe e gurë



për të realizuar një lidhje tokësore me të. Kalaja ka formë planimetrike trekëndore me tre bastione të fuqishme nëpër qoshet. Hyrja ndodhet në mesin e murit jugor.

Kjo kështjellë qëndron në mes të detit dhe legjendës, bukuria e kësaj kështjelle, e ndërtuar rreth dy shekuj më parë, është e tëra me konstruktion guri.

Ajo ka fituar statusin “Monument Culture” dhe është nën kujdesin e Institutit të Monumenteve të kulturës.

### Kisha e Shën Stefanit

Kisha e Shën Stefanit gjendet në afërsi të plazhit të Dhërmiut. Është një kishë kapelë e rindërtuar në shek. XVIII-XIX mbi rrënojat e një kisha që i përkiste shek. XI-XII, gjurmë të së cilës i ruan akoma. Në këtë kishë ruhen vlera të artit kishtar të vendit tonë. Aty ruhen pikturat e reja murale të punuara në shek. XVIII, edhe piktura të punuara në kishën e vjetër në shek. XI-XII. Në një mbishkrim, që gjendet në ikonostasin e saj shkruhet: “U pikturua me dorën e Mihalit dhe të Konstandinit nga eparkia e shenjtë të Vellasë”. Kisha është Monument i Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje.



### Kisha e Manastirit të Panaiasë, Dhërmi

Kisha e Panaiasë ndodhet ngjitur me rrugën kryesore në Dhërmi, rreth 250 m larg detit. Kisha është një monument i trashëgimisë kulturore. Panagia, në greqishten mesjetare dhe moderne, është një nga titujt e Marisë, nënës së Jezusit, e përdorur veçanërisht në katolicizmin lindor dhe krishterimin ortodoks.

Shumica e kishave mbajnë emrin e Virgjëreshës Mari, pasi Maria konsiderohet më e shenjtë nga të gjitha qeniet njerëzore. Kisha është e hapur për të gjitha ritet fetare, që zhvillojnë banorët e fshatit.



NGA SUELA HODA

# 16 prilli, memorial i eksodit 1999

## “Kulla e Qëndresës”

Tashmë është bërë traditë që çdo vit, më 16 prill, në qytetin e Kukësit të përkujtohet eksodi i vitit 1999, periudha e vështirë kur shqiptarët e Kosovës, për t'i shpëtuar tmerrit të luftës, u drejtuan drejt kufijve të Shqipërisë.

Ky përkujtim për herë të parë filloi në vitin 2000, vetëm një vit pas eksodit dhe arsyeja e vendosjes së kësaj date ishte sepse ishte data kur, me ndërhyrjen e NATO-s, forcat serbe u larguan përfundimisht nga Kosova.

16 prilli do të kujtohet gjithmonë si ditë feste, sepse pikërisht në këtë datë, çdo vit, shqiptarët e Kosovës marshojnë drejt qytetit të Kukësit, për të kujtuar dhe festuar bashkë me qytetarët kuksianë, ditën kur ata mundën të ktheheshin në vendin e tyre, tashmë të çliruar.

Në këtë ditë, çdo vit organizohen aktivitetet e koncerte, ku mbledhen artistë nga të gjitha trevat shqiptare.

Në kujtim të atyre kohëve të vështira, si dhuratë nga Kosova, në Kukës është ndërtuar “Kulla e Qëndresës” ose Obelisku, simboli i eksodit të vitit 1999, ku mbahen të gjalla kujtimet e luftës së Kosovës. Obelisku është një monument i bërë prej guri, i ngjashëm me një kolonë.

Ky është një objekt muzeal, ku janë të afishuara qindra foto, në kujtim të pranverës së vitit 1999. Në vitin 2000, Kukësi u kandidua për Çmimin Nobel për Paqe, me motivacionin “e pritjes së mbi 450 000 shqiptarëve nga Kosova të dëbuar nga ushtria, paraushtarakët serbë dhe serbët e armatosur në Kosovë”. Kështu, Kukësi u bë qyteti i parë në botë i kandiduar për një çmim të tillë, për mikpritjen dhe bujarinë ndaj popullit kosovar.

*“A do male me dëborë  
Trima të fortë e malësorë  
Fort bujarë e burrërorë  
Shkon në Kukës i ke në dorë”*

Vargjet e mësipërme, që i janë atribuar njërit prej personazheve më të rëndësishme të historisë shqiptare, Fan Nolit, në fakt janë shumë afër me karakteristikat e vërteta të kuksianëve. Kuksianët vazhdojnë t'i ruajnë këto tradita e zakone edhe në ditët e sotme dhe



31 tetor 2005, si financim – dhuratë nga qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe.

Aeroporti i Kukësit u rindërtua dhe u vu në funksion të plotë në vitin 2021 dhe, më 18 prill 2021, u krye fluturimi i parë ajror komercial me avionin e “Air Albania” dhe pasagjerë të ardhur nga Anglia.

Tashmë, Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit, ZAYED - “Flatrat e Veriut”, është plotësisht funksional, ka një pistë prej 2.2 kilometrash dhe kullën e saj të vrojtimit, ndërsa në pjesën e vendqëndrimit të avionëve, është projektuar për të mbajtur 3 avionë njëkohësisht, ndërkohë që brenda një ore mund të nisen 4 avionë nga Aeroporti i Kukësit.

## Eksodi 1999, përjetimet në Kukës

Më 24 mars, në orën 20:00, Komandanti Suprem i Aleatëve të NATO-s për Evropën (SACEUR), Wesley Clark, me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, nisi fushatën bombarduese kundër Jugosllavisë.

Fushata bombarduese e NATO-s zgjati nga 24 marsi deri më 11 qershor 1999. Në mbi dhjetë javët e konfliktit, avionët e NATO-s fluturuan mbi 38 000 misione luftimi.

Qëllimi i paracaktuar i NATO-s u përmbodh nga zëdhënësit e saj si “serbët jashtë, paqeruajtësit brenda, refugjatët të kthehen”. Trupat jugosllave duhej të largoheshin nga Kosova, ata do të zëvendësoheshin nga paqeruajtësit ndërkombëtarë në mënyrë që të siguronin që refugjatët shqiptarë të ktheheshin në shtëpi.

Ndërkohë, shqiptarët e Kosovës vazhdonin të shpërnguleshin nga terrori serb në Kosovë.

Më 27 mars, në orën 13:20, në pikë-kalimin doganor të Morinës hynë 187 refugjatët e parë nga

Kosova, ku shumica ishin fëmijë dhe gra, të cilët ishin në gjendje të mjerueshme fizike dhe mendore dhe të plagosur me mjete të forta si: qyta pushke, shkopinj gome etj. Ata ishin kryesisht banorë të fshatrave të Prizrenit, Krushë e Madhe dhe Zym. Deri në orën 19:30 kanë hyrë rreth tre mijë kosovarë brenda territorit të Kukësit. Ndërsa deri në orën 24.00 të 27.03.1999 në Kukës mbërritën 12 721 kosovarë. Ndihamat e para ushqimore erdhën nga Ministria e Bujqësisë, ku u dërguan kontingjente me ushqime për 2500 persona në muaj.

Më 28 mars, vazhdoi fluksi i të ardhurve kosovarë, të dëbuar me forcë prej trojeve të tyre. Numri i tyre ishte 13 000 banorë. Refugjatët Kosovarë kishin hyrë nga pikë-kalimi i Morinit, ku edhe ishin dhunuar, torturuar, masakruar dhe zhveshur nga policët serbë, duke u marrë paratë, bizhuteritë dhe çdo send me vlerë që ato kishin.

Vendstrehimi i tyre përkohshëm ishte Pallati i kulturës “Hasan

Prishtina”. Më pas pushteti lokal në Kukës hapi dyert e disa mjediseve shkollore, çerdhesh, kopshtesh, magazinash dhe deposh për strehimin e të dëbuarve. Refugjatët e tjerë u strehuan dhe u mikpritën në familje kuksiane,

Mesatarisht çdo familje në qytetin e Kukësit kishte rreth 14 kosovarë. Ata flinin në çdo pjesë të shtëpisë.

Në krye të javës mbërriti karvani i dytë i të dëbuarve, me rreth 70 000 kosovarë. Nga këto 40 000 u sistemuan pranë familjeve qytetare, 10 000 në mjedise të ndryshme publike të qytetit, 6 000 në komunat Bicaj, Kolsh, Tërthore dhe Shtiqën, 12 000 në qytetin e Krumës dhe 300 në komunën Golaj. Në Kukës mbërritën 16 automjete për të evakuuar një pjesë të kosovarëve në qytete të tjera, por ata refuzuan sepse kishin gjetur mikpritjen dhe bujarinë e vendasve. Dita-ditës numri i të dëbuarve rritej.

Kamionët sillnin mijëra tonë miell, bukë dhe ushqime. Çdo ditë shpërndaheshin miliona pako me oriz, dyfishi i tyre me sheqer, mijëra ton biskota, mish i konservuar, miliona pako makarona, gota plastike dhe shishe me ujë të pijshëm. Disa Ndihma ushqimore erdhën nga biznesmenët të shumtë kuksianë, të cilët ndanë ndihma të konsiderueshme ushqimore për familjet që kishin strehuar refugjatët kosovarë. Edhe furrat e bukës filluan të punonin 24 orë pa pushim. Kryqi i kuq Shqiptar, dega Kukës filloi shpërndarjen e ndihmave. Gjatë kësaj periudhe u vu në punë Fabrika e Blojës e qytetit të Kukësit, për të bluar 200 tonë grurë. Shoqata të ndryshme e fondacione shqiptare, kosovare dhe të huaja humanitare shpërndanë për kosovarët e dëbuar ushqime, rroba dhe veshmbathje dhe ndihma të shumëllojshme.

Spitali i Kukësit kryente 2 000 vizita mjekësore në ditë. Çdo 5-10 minuta vinin njerëz të plagosur, të rrahur, të masakruar dhe përdhunuar nga forcat serbe. Në qytetin e Kukësit funksiononte spitali fushor për të dëbuarit, i cili kishte sallë të urgjencës, të lindjes, farmaci dhe qendrën ku ndihma mjekësore jepej falas. U krijua menjëherë shtabi i emergjencës që të përballonte situatën. U hap një qendër shëndetësore për mjekim falas me dy mjekë shqiptarë dhe një Italian. UNICEF-I dha një ndihmë shumë të madhe, duke dërguar në Kukës 60 000 doza vaksinash DTP (difteri, tetanozi) për vaksinimin e fëmijëve. Gjithashtu ngriti 3 qendra për trajtimin e fëmijëve të traumatizuar nga dhuna serbe.

Me datë 10 qershor ora 01.00, NATO pas bisedimeve të




më shumë se kurrë, populli kuksian e ka treguar bujarinë dhe mikpritjen gjatë periudhës së vështirë të vitit 1999.

## Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit, “ZAYED - Flatrat e Veriut”

Gjatë krizës në vitin 1999, Emiratet e Bashkuara Arabe organizuan në Kukës një kamp modern për të ndihmuar refugjatët e luftës në Kosovë. Së pari, ata zhvilluan një pistë ajrore për furnizimet e ndihmave hyrëse në Kukës. Në atë kohë, përfaqësuesit e Emirateve të Bashkuara Arabe paraqitën idenë për zhvillimin e aeroportit civil si një dhuratë për këtë zonë, e cila u përball me fluksin më të madh të qytetarëve të Kosovës.

Ndërtimi i aeroportit nisi më 10 maj 2003 dhe përfundoi më



shumta, vendosi pezullimin e bombardimeve ndaj trupave serbe në Kosovë. Ata kishin një kusht, tërheqja e serbëve nga Trojet Kosovare. Më pas menjëherë 18 furgonë me 140 kosovarët e parë u nisën drejt Kosovës. Më 13 qershor, qytetarët e Kukësit përshëndetën trupat gjermane që u nisën drejt Kosovës dhe kaluan në pikën kufitare të Morinit.

Pavarësisht strehimit në shtëpitë e banorëve kuksianë, një numër i madh kosovarësh strehoheshin në kampe. Gjatë periudhës së krizës funksiononin 8 kampe, ku u strehuan 30 000 shqiptarë të Kosovës të dëbuar.

Edhe sistemi arsimor ishte në gatishmëri për t'i mirëpritur, si fëmijët kosovarë po ashtu edhe stafin pedagogjik, për t'i përfshirë në procesin mësimor, duke mos lejuar shkëputjen nga arsimimi.

Më 7 qershor 1999, filloi shkolla verore për fëmijët kosovarë. Në këtë datë u regjistruan 12700 nxënës. Për zhvillimin e mësimin u vunë në dispozicion 26 shkolla verore, 18 objekte shtëpi dhe 8 shkolla te improvizuara.

**M**ë 15 prill 1979, në Shqipëri ra një prej tërmeteve më të forta të 100 viteve të fundit. Burimet zyrtare të kohës bënin fjalë për një prej lëkundjeve më të forta të kohës që në pak sekonda u mori jetën 35 personave si dhe lëndoi 176 persona të tjerë në rrethet e Lezhës dhe të Shkodrës. Tërmeti përkoi me vitin e parë të krizës së madhe që kishte nisur në Shqipëri, pas vetë-izolimit skajor që kishte ndërmarrë regjimi komunist pas prishjes së marrëdhënieve ekonomike dhe politike me Kinën. Kësisoj regjimi e kishte në qendër të propagandës reklamën se ai mund t'i shuante pasojat e tërmetit i vetëm pa asnjë lloj ndihme. Si kudo, në raste të tilla fatkeqësish, vende të ndryshme të botës ofrojnë ndihmën e tyre për kapërcimin sa më të shpejtë të pasojave. Natyrisht regjimi komunist refuzoi ndihmën që ndërkombëtarët i ofruan Shqipërisë me ndihma ushqimore dhe materiale nëpërmjet OKB-së.

Ky refuzim erdhi për disa arsye, së pari do konsiderohej si "hapje ndaj botës". Kjo hapje mund të sillte penetrimin e "agjenturave të huaja" në vendin tonë, a thua se ne ishim në qendër të të gjithë botës, së dyti regjimi kishte frikë nga ajo që të huajt do të shihnin në Shqipëri. Jo se për të huajt nuk dihehin gjërat në Shqipëri, por se për ta do të ishte më e qartë, se sa thellë kishte shkuar e keqja në vend. Po ashtu nga ndihmat e ardhura do të shihej se shtetet perëndimore ishin në teknika dhe në mjete shumë herë më lart se shtetet e lindjes komuniste, së treti, dhe më kryesorja ishte se regjimi kërkonte ta kalonte me megalomani të theksuar, e cila i tregonte shqiptarëve që ne me këtë regjim i mbyllnim shpejt plagët e hapura nga një fatkeqësi natyrore. Partia e Punës dhe Këshilli i Ministrave shpallën mobilizimin e madh. Direktivat komuniste u përzien me humanizëm të shtirur dhe në vend nisi puna për "rëndësimin e pasojave të tërmetit".

#### Bilanci i tërmetit të 15 prillit 1979

- 35 të vdekur, 176 të plagosur, 5115 shtëpi banimi u dëmtuan
- Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë  
Ministria e Punëve të Brendshme
- Tiranë më 16.4.1979  
Komunikatë operative nr.89  
Qendra sizmologjike, Tiranë

Më 15.4.1979 ora 07.19 një tërmet shumë i fortë me magnitudë 7.25 sipas shkallës Rihter ndodhi 130 km në veriperëndim të Tiranës, me epiqendrë në detin Adriatik. Intensiteti i tërmetit në epiqendrë ka qenë mbi 9 ballë sipas shkallës MSK-1964. Është ndër tërmetet më të forta të regjistruar në këtë shekull në territorin e Ballkanit.

Në territorin e vendit tonë, në bregun e lumit Buna intensiteti i tërmetit ka qenë rreth 8 ballë MSK-1964. Tërmeti shkaktoi 35 të vdekur dhe 176 të plagosur në rrethet e Shkodrës dhe të Lezhës. Në këto dy rrethe u shkatërruan 1730 shtëpi banimi dhe u dëmtuan 5115 shtëpi banimi, objekte ekonomike dhe social kulturore. Dëme u shkaktuan edhe në rrethet



# Tërmetet më të fuqishëm që kanë goditur Shqipërinë



Krujë, Pukë, Dibër, Tropojë, Mat dhe Mirditë. Lëkundjet e këtij tërmeti u ndjenë në të gjithë territorin e vendit tonë, si dhe në gjithë Jugosllavinë, Greqinë Veriore, në Bullgari, në Itali, në Austri dhe në Gjermaninë jugore. Tërmeti shoqërohet me shumë pasgoditje. Deri në orën 21.00, stacioni qendror i Tiranës ka regjistruar 206 pasgoditje, disa nga të cilat kanë pasur magnitudë mbi 4.0. Më e forta nga to ndodhi në orën 15.43 me magnitudë rreth 6, sipas shkallës Rihter; lëkundjet e kësaj goditjeje janë ndjerë edhe në Tiranë.

Nga njoftimet e Degëve të Punëve të Brendshme rezultonte se në Shkodër veç të vrarëve e të plagosurve janë dëmtuar 80 % e shtëpive të zonës së Velipojës, Bushatit, Barbullushit, në zonën e Dajçit dhe në fshatin Pentarë janë rrënuar krejtësisht 80% e shtëpive. Janë dëmtuar rëndë banesat e pikave kufitare Reç, Pulaj, Rushkull e Pentarë, kurse në efektin nuk ka asnjë dëm. Në Lezhë ka dalë jashtë përdorimit furra e bukës të qytetit, është dëmtuar depoja e vjetër e ujit të pijshëm të qytetit, rrjeti elektrik dhe ai i ujit, ndërsa në fabrikën e letrës kanë ndërprerë prodhimin dy reparte.

Tiranë më 17.4.1979  
Komunikatë operative nr. 90  
Qendra sizmologjike, Tiranë

Deri në orën 21.30 datën 16.4.1979 stacioni qendror i Tiranës ka regjistruar gjithsej 513 pasgoditje të tërmetit të datës 15.4.1975. Pasgoditja më e fortë ra në orën 11.04 me intensitet në qendër 7 ballë MSK-1964, në Shkodër 6 ballë, ndërsa në Tiranë 3 ballë. Nga studimi i shpërndarjes së hapësirës së pasgoditjeve të tërmetit të datës 15.04.1979 rezultoi se aktiviteti sizmik zë një zonë thuhet lineare me gjatësi rreth 100 km përgjatë bregdetit Adriatik, rreth 20-30 km larg bregut, nga Ulqini deri në Hercegovinë.

Vendi ynë është një vend i dalluar në Europë për aktivitetin e tij sizmik, i cili ndodh kryesisht në disa breza sizmogjen siç është ai Adriatiko-Jonian, brezi Korçë-Ohër-Peshkopi dhe brezi Vlorë-Lushnje-Elbasan-Dibër. Në historinë e vendit tonë janë regjistruar tërmete të forta që kanë shkatërruar qindra banesa e kanë marrë qindra jetë njerëzish.

Afërsisht, çdo vit në Shqipëri shkaktohen 4-5 tërmete me forcë 6

ballë dhe çdo 25 vjet shkaktohet 1 tërmet me forcë afro 9 ballë, duke e bërë kështu Shqipërinë një rajon me aktivitet të lartë sizmik.

Nga lashtësia njihen si tërmete më të fuqishme ai i Apolonisë në vitin 217 e. s., në Durrës në vitet 334 dhe 506 të erës sonë, si dhe në vitin 1273.

Gjithashtu përmenden dhe tërmetet e Butrintit në vitin 1153 dhe të Krujës në vitin 1617.

Nga studimet e pakta që kanë ardhur deri në ditët tona rezultoi se gjatë shekullit të 19-të në Shqipëri janë ndjerë 77 tërmete me mbi 7 ballë.

Për të ardhur tek ai i tre viteve më parë, ku humbën jetën 51 persona dhe u plagosën qindra të tjerë. Pa harruar edhe dëmet e mëdha materiale.

#### Tërmetet më të fuqishëm që kanë goditur Shqipërinë:

- Vlorë më 12 tetor 1851, duke shkaktuar 20 të vrarë.
- Tërmeti më i madh në Shqipëri është regjistruar në Berat, më 17 tetor 1851, duke shkaktuar 400 të vrarë në Kala.
- Shkodër në muajt shkurt-tetor 1855, 12 tërmete që u ndjenë dhe në Delvinë dhe Bari të Italisë.

- Shkodër më 1 qershor 1905, që shkaktoi 1500 shtëpi të shkatërruara, 200 të vrarë dhe 500 të plagosur.

- Tepelenë, më 20 nëntor 1920, duke shkaktuar 36 të vrarë dhe 102 të plagosur. Ai shkatërroi 2 500 shtëpi e la pa strehë 15 000 veta.

- Peshkopi më 24 gusht 1924, duke shkaktuar afro 80 % të shtëpive, 44 të vrarë dhe 119 të plagosur,

- Vlorë-Tepelenë, më 21 nëntor 1930, duke shkaktuar 30 të vrarë e mbi 100 të plagosur.

- Fier-Tepelenë-Berat-Lushnjë, më 18 mars 1962, duke shkaktuar 5 të vrarë e 77 të plagosur dhe ku u shkatërruan 2 700 shtëpi.

- Dibër-Librazhd, më 30 nëntor 1967, duke shkaktuar 177 fshatra, ku gjetën vdekjen 12 veta dhe 174 të tjerë u plagosen.

Karakteristike e këtij tërmeti është thyerja e tokës me gjatësi mbi 10 kilometra e zhvendosja vertikale e dheut deri në 50 centimetra.

- Shkodër-Lezhë, më 15 prill 1979, duke dëmtuar 17 118 shtëpi e objekte social-kulturore.

- Roskovec, më 17 nëntor 1982, duke u ndjerë tërmeti edhe në Fier, Librazhd e Berat, ku u shkatërruan 16 534 ndërtesa, u vra 1 person dhe 12 te plagosur.

- Tiranë më 7 janar 1988, u dëmtuan 2083 shtëpi.

- 26 nëntor 2019 do të regjistronte një nga tërmetet më shkatërrimtar në dekadat e fundit, me magnitudë 6,3 ballë sipas shkallës Rihter.

Epiqendra e tërmetit ishte brenda territorit të Qarkut të Durrësit, 30 kilometra nga Tirana.

Për pasojë 51 persona humbën jetën, 913 të tjerë u plagosën, mijëra të tjerë u ndikuan në shëndetin e tyre. 202 291 persona u prekën në vend, ku 47 263 në mënyrë direkte dhe 155 029 në mënyrë indirekte, ndërsa 17 000 persona u zhvendosën nga banesat e tyre.

Bashkitë më të prekura ishin Durrës, Shijak, Krujë, Tiranë, Kamëz, Kavajë, Kurbin dhe Lezhë.

# MINISTRI PELESHI:

Pagat e ushtarakëve ishin për një kohë të gjatë një arsye për t'u ndjerë keq për trupat e Forcave të Armatosura, por s'kishim asnjë rrugë tjetër përveçse të çonim përpara me këmbëngulje e durim ndryshimet e domosdoshme, pa të cilat pagat nuk mund të rriteshin siç duhej dhe siç e dëshironim të gjithë. Tanimë kushtet kanë ndryshuar shumë dhe ushtarakët tanë nuk janë më të fundit e rajonit për nivelin e pagave të tyre, ata kanë paga ndër më të lartat, të cilat do të vazhdojmë t'i rrisim drejt mesatares së NATO-s. Rritja me 37% do të pasohet me një tjetër rritje në vitin 2024.

